

VENDIM
Nr. 62, datë 26.3.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“MALËSIA SOLAR 2” SHPK PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK NË LAHË E POSHTME,
SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullave “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 1047/1 prot., datë 6.3.2018, shoqëria “Malësia Solar 2” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.

- Aplikimi i shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 (gjerat “a”, “c”, “d”), 4.4.4 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit); pa plotësuar

- Nenin 9, pika 4.4.3, germa “b” (një diagram elektrik në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes); do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me fuqi të instaluar 2500 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti